



DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Administrata Doganore Shqiptare

dogana.shqiptare Dogana Shqiptare

Newsletter | Mars 2026

DELEGACIONI I KE VIZITË MONITORUESE NË ADMINISTRATËN DOGANORE SHQIPTARE

Delegacioni i ekspertëve të Drejtorisë së Përgjithshme për Tatimet dhe Bashkimin Doganor në Komisionin Europian, DG TAXUD, zhvilloi në Tiranë vizitën monitoruese mbi vlerësimin e kapaciteteve të Administratës Doganore Shqiptare në funksion të procesit të integritetit evropian. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, vlerësoi rëndësinë e kësaj vizite monitoruese si një moment të rëndësishëm për të reflektuar mbi progresin e arritur dhe për të identifikuar hapat e mëtejshëm në procesin e përafrimit me standardet europiane. Ai theksoi se Administrata Doganore Shqiptare është e angazhuar për të vijuar reformat në drejtim të modernizimit, digjitalizimit dhe forcimit të integritetit institucional, duke nënvizuar se bashkëpunimi i ngushtë me ekspertët e DG TAXUD mbetet thelbësor për rritjen e kapaciteteve dhe përgatitjen e sistemit doganor për sfidat e ardhshme të integritetit në Bashkimin Europian. Nga ana e saj, përgjegjësjë e ekipit të ekspertëve të DG TAXUD, Verle Clearhout, vlerësoi bashkëpunimin dhe transparencën e treguar nga Administrata Doganore Shqiptare gjatë gjithë procesit të monitorimit. Ajo përgëzoi stafin doganor për angazhimin dhe profesionalizmin e treguar, duke theksuar se kjo vizitë ofroi një pasqyrë të qartë mbi mënyrën e funksionimit të strukturave dhe procedurave doganore në Shqipëri. Vizita monitoruese e ekspertëve të DG TAXUD përbën një hap të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të kapaciteteve të Administratës Doganore Shqiptare dhe në forcimin e bashkëpunimit me institucionet e Bashkimit Europian në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE.



DREJTORI I DOGANAVE PRET TË NGARKUARËN ME PUNË TË AMBASADËS SË SHBA NË SHQIPËRI

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, priti në një takim të Ngarkuarën me Punë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, znj. Nancy VanHorn. Takimi u fokusua në forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e administrimit doganor, sigurisë kufitare dhe lehtësimit të tregtisë, duke theksuar rëndësinë e partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjatë bashkëbisedimit, z. Beja nënvizoi angazhimin e Doganës Shqiptare në luftën kundër trafikëve të paligjshme, kontrabandës dhe korrupsionit, si dhe në garantimin e kontrollit efektiv të lëvizjes së mallrave në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë. Znj. VanHorn vlerësoi rolin kyç të Doganës Shqiptare në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe trafikut të narkotikëve, rritjen e të ardhurave buxhetore dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për investime. Palët diskutuan gjithashtu mbi mundësitë konkrete për thellimin e asistencës teknike, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe avancimin e projekteve që kontribuojnë në rritjen e eficientës së administratës doganore dhe lehtësimin e tregtisë së ligjshme.



PLATFORMË DIALOGU MBI DRITAREN E VETME KOMBËTARE PËR DOGANAT

Në Tiranë u zhvillua Platforma e Dialogut mbi Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat (National Single Window), një iniciativë që synon modernizimin e proceseve të tregtisë ndërkufitare dhe lehtësimin e procedurave për biznesin. Aktiviteti mbledhi përfaqësues të institucioneve shtetërore, komunitetit të biznesit dhe partnerëve ndërkombëtarë për të diskutuar mbi qeverisjen, zbatimin dhe partneritetin në këtë projekt strategjik. Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, u shpreh se projekti i Dritares së Vetme Kombëtare përbën një nga iniciativat më gjithëpërfshirëse institucionale për lehtësimin e biznesit dhe modernizimin e administratës. Ai theksoi se Drejtorja e Përgjithshme e Doganave është e angazhuar të kontribuojë plotësisht në këtë proces përmes bashkëpunimit institucional dhe zhvillimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. Dritarja e Vetme në Dogana është një platformë digjitale që u mundëson bizneseve të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar për importin ose eksportin e mallrave përmes një sistemi të vetëm online. Dokumentet dhe të dhënat shpërndahen automatikisht tek të gjitha institucionet përgjegjëse, duke eliminuar nevojën për paraqitjen e tyre në mënyrë të veçantë në çdo agjenci.

TAKIM BILATERAL SHQIPËRI - MALI ZI PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT DOGANOR

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, zhvilloi vizitën e tij të parë zyrtare bilaterale në Mal të Zi, ku u prit nga Drejtoresha e Përgjithshme e Doganave të Malit të Zi, znj. Maja Vuçiniç. Takimi, i zhvilluar në Podgoricë, konfirmoi marrëdhëniet e mira të bashkëpunimit ndërmjet dy administratave doganore dhe vullnetin për ta thelluar më tej atë në funksion të integritetit evropian. Gjatë takimit u diskutua mbi rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe lehtësimin e procedurave doganore për biznesin, si dhe mbi forcimin e bashkëpunimit në kuadër të nismave rajonale, përfshirë CEFTA dhe projektet për shkëmbimin elektronik të të dhënave. Palët vlerësuan pozitivisht bashkëpunimin ekzistues, duke nënvizuar nevojën për intensifikimin e mëtejshëm të tij përmes rritjes së operacioneve të përbashkëta, shkëmbimit në kohë reale të informacionit dhe zhvillimit të kapaciteteve.



DREJTORI I DOGANAVE TAKON AMBASADORIN E MBRETËRISË SË BASHKUAR NË SHQIPËRI

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, priti në një takim Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, Nicholas Abbott, ku në fokus ishte forcimi i mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh në fushën doganore dhe atë të sigurisë kufitare. Gjatë bisedës, Drejtori Beja vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme që Mbretëria e Bashkuar i ka ofruar Administratës Doganore Shqiptare, duke theksuar se, "partneriteti me institucionet britanike ka qenë thelbësor në rritjen e kapaciteteve operationale dhe në modernizimin e procedurave të kontrollit". Nga ana e tij, Ambasadori Abbott vlerësoi progresin e bërë nga Dogana Shqiptare dhe shprehu gatishmërinë për thellimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, duke u shprehur se, "Shqipëria mbetet një partner i rëndësishëm për Mbretërinë e Bashkuar në adresimin e sfidave të përbashkëta, si lufta kundër kontrabandës, trafikëve të paligjshme dhe forcimi i kontrollit në kufi". Palët diskutuan gjithashtu mbi nevojën për intensifikimin e shkëmbimit të informacionit dhe përdorimin e teknologjive të avancuara për analizën e riskut, në funksion të përbashkët të sfidave të reja që lidhen me sigurinë dhe tregtinë ndërkombëtare.



ME DREJTUESËN E SEKRETARIATIT TË CEFTA-S

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, priti në një takim Drejtoreshën e Sekretariatit të CEFTA-s, (Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore), znj. Pranvera Kastrati, ku në qendër të diskutimit ishte roli i Shqipërisë në kuadër të Presidencës së CEFTA-s për vitin 2026 dhe prioritetet në fushën e bashkëpunimit doganor. Gjatë bisedës, Drejtori Beja vlerësoi rolin e CEFTA-n si një mekanizëm thelbësor për forcimin e stabilitetit ekonomik dhe sigurisë tregtare në rajon, si dhe si një platformë konkrete për afrimin e vendeve anëtare me tregun e përbashkët evropian. Takimi riafirmoi angazhimin e përbashkët për të vijuar me hapa konkretë drejt një bashkëpunimi edhe më të strukturuar, duke e shndërruar Presidencën e Shqipërisë në CEFTA një mundësi për të konsoliduar arritjet e deritanishme dhe për të çuar përpara procese që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e klimës së biznesit dhe në avancimin e integritetit ekonomik rajonal dhe evropian.

DREJTORI I DOGANAVE TAKIM ME UNODC PËR FORCIMIN E KONTROLLIT KUFITAR

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një takim me një delegacion të UNODC, (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin), të kryesuar nga Danilo Rizzi, Përfaqësues Rajonal për Europën Juglindore (SEE) në kuadër të konsolidimit dhe thellimit të bashkëpunimit në fushën e kontrollit kufitar dhe luftës kundër trafikëve të paligjshme. Gjatë takimit, Drejtori i Përgjithshëm shprehu gatishmërinë dhe angazhimin e Administratës Doganore Shqiptare për vijimin dhe forcimin e bashkëpunimit me UNODC, me synim rritjen e kapaciteteve të strukturave doganore në parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve të paligjshme ndërkufitare. Palët ndanë një vizion të përbashkët për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës së kontrollit kufitar, bazuar në një vlerësim të qartë të nevojave konkrete të administratës doganore, si dhe për forcimin e ekspertizës profesionale në këtë fushë.





DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Administrata Doganore Shqiptare

dogana.shqiptare Dogana Shqiptare

Newsletter | Mars 2026



TAKIM ME KOORDINATORIN NDËRKOMBËTAR TË PROJEKTIT EU4LEA 2

Drejtoria e Doganave, Z. Besmir Beja, zhvilloi një takim pune me Koordinatorin Ndërkombëtar të Projektit EU4LEA 2 (Bashkimi Europian për Zbatimin e Ligjit në Shqipëri), Z. Giovanni Pasqua, ku u diskutuan hapat e ardhshëm të bashkëpunimit dhe prioritetet në kuadër të fazës së dytë të zbatimit të projektit. Gjatë takimit u theksua rëndësia e Doganës si një nga institucionet kyçe në detektimin fillestar të krimeve ndërkufitare, si dhe roli i saj në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rajonal për parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve të paligjshme. Gjatë diskutimeve u trajtuan gjithashtu mundësitë për zgjerimin e përdorimit të softuerëve të analizës së të dhënave dhe zhvillimin e mëtejshëm të analizës së riskut, në kuadër të forcimit të kapaciteteve teknologjike të Administratës Doganore. Në fokus ishte edhe ndikimi i teknologjive të reja, përfshirë përdorimin e inteligjencës artificiale në aktivitetet kriminale, si dhe nevoja për zhvillimin e instrumenteve analitike për t'i adresuar këto sfida në mënyrë më efektive.



BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL SHQIPËRI-ITALI

Drejtoria e Doganave, Besmir Beja, u prit në një takim nga Ambasadori i Republikës së Italisë në Shqipëri, Sh.T. Marco Alberti. Gjatë takimit u diskutua mbi forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy vendeve, me fokus në rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe në rolin e administratave doganore në lehtësimin e lëvizjes së mallrave dhe pasagjerëve. Drejtoria e Doganave, z. Beja, vlerësoi partneritetin e ngushtë me autoritetet italiane dhe mbështetjen e vazhdueshme të Italisë për institucionet shqiptare. Nga ana e tij, ambasadori Alberti theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën doganore dhe të sigurisë kufitare, duke nënvizuar se Italia mbështet përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e institucioneve dhe avancimin në rrugën drejt integritetit evropian. Gjatë bisedës u diskutua gjithashtu mbi projekte të reja të përbashkëta mes administratave doganore të dy vendeve, përfshirë bashkëpunimin me Guardia di Finanza, si dhe për rinovimin e Planit të Veprimit që synon të thellojë bashkëpunimin operacional dhe institucional mes dy anëve të Adriatikut.



DREJTORIA I DOGANAVE PRET DREJTUESIT E AMCHAM PËR FORCIMIN E DIALOGUT ME BIZNESIN

Drejtoria e Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një takim pune me drejtues të Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri, AmCham. Gjatë takimit, u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Administratës Doganore dhe Dhomës Amerikane të Tregtisë, si një nga aktorët kryesorë në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të komunitetit të biznesit amerikan në Shqipëri. Palët vlerësuan rëndësinë e këtij partneriteti në adresimin e çështjeve konkrete të biznesit, si dhe në ndërtimin e një dialogu të qëndrueshëm dhe konstruktiv. Një tjetër çështje e rëndësishme e diskutuar ishte organizimi i forumit të ardhshëm të biznesit mes Administratës Doganore dhe AmCham, i planifikuar për muajin qershor, i cili pritet të shërbejë si një platformë e hapur komunikimi ku përfaqësuesit e biznesit do të kenë mundësi të diskutojnë drejtpërdrejt problematikat dhe sfidat që hasin në aktivitetin e tyre të përditshëm.

SHQIPËRIA MERR KRYESIMIN E CEFTA PËR VITIN 2026

Në kuadër të Kryesimit të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA) nga Shqipëria gjatë vitit 2026, më 18 mars u zhvillua në Tiranë prezantimi i prioritetëve dhe programeve të punës së CEFTA-s për vitin 2026. CEFTA është një marrëveshje rajonale që synon krijimin e një zone të lirë tregtare ndërmjet vendeve të Europës Juglindore, duke lehtësuar lëvizjen e mallrave, reduktuar barrierat tregtare dhe duke harmonizuar procedurat ndërmjet administratave përkatëse. Në këtë kuadër, Dogana Shqiptare luan një rol kyç në zbatimin praktik të marrëveshjes, duke qenë institucioni përgjegjës për kontrollin, verifikimin dhe certifikimin e origjinës së mallrave, si dhe për garantimin e zbatimit korrekt të procedurave preferenciale tregtare. Rëndësia e këtij roli u reflektua edhe gjatë vitit të kaluar, kur Dogana Shqiptare mbajti kryesimin e Nënkomitetit të CEFTA-s për Rregullat e Origjinës, duke kontribuar aktivisht në avancimin e diskutimeve teknike dhe përmirësimin e mekanizmave të zbatimit në nivel rajonal.



PREZANTOHET DREJTUESI I RI I DEGËS DOGANORE DURRËS

Drejtoria e Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një vizitë pune në Degën Doganore Durrës, ku prezantoi drejtuesin e ri të kësaj dege, Drilon Bushati. Gjatë prezantimit, Drejtoria e Doganave theksoi se z. Bushati merr sot këtë detyrë të rëndësishme pas një përvojë të gjatë në sistemin doganor, ku ka mbajtur një sërë pozicionesh drejtuese dhe ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në forcimin e administratës doganore. Në fjalën e tij drejtuar stafit, z. Beja kërkoi angazhim maksimal, devotshmëri dhe profesionalizëm në përmbushjen e detyrave, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe integritetit në punë. Ai inkurajoi stafin që të mbështesë drejtuesin e ri dhe të vijojë me të njëjtin përkushtim në realizimin e prioritetëve të institucionit. Ai vlerësoi kontributin dhe angazhimin e drejtuesit që përfundoi detyrën, Denis Shabani, për punën e kryer dhe rezultatet e arritura gjatë drejtimit të kësaj dege.

DREJTORIA I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE NË QAFË THANË

Drejtoria e Doganave, Besmir Beja zhvilloi një inspektim në Degën Doganore Qafë Thanë për të ndjekur nga afër situatën në këtë pikë kufitare, pas vështirësive të krijuara nga bllokimi i qarkullimit në aksin rrugor Tiranë-Librazhd, që për disa ditë ndikoi edhe në lëvizjen e mjeteve të transportit dhe veçanërisht të kamionëve. Drejtoria Beja u njoh me situatën aktuale dhe masat e marra për menaxhimin e fluksit, ndërsa aktiviteti në pikën doganore iu rikthye normalitetit me rifillimin e qarkullimit të rregullt të mjeteve. Gjatë inspektimit, Drejtoria e Doganave zhvilloi gjithashtu takime me drejtuesit dhe punonjësit e degës, ku u diskutua mbi funksionimin e procedurave doganore, menaxhimin e fluksit dhe rëndësinë e ruajtjes së standardeve të kontrollit dhe shërbimit.



BLOKOHEN 920 PAJISJE ELEKTRONIKE

Në vijim të kontrolleve të vazhdueshme për respektimin e ligjshmërisë, Degën Doganore Rinas ka bllokuar 920 pajisje elektronike "Apple" dhe "Samsung", prej të cilëve 510 celularë të llojeve të ndryshëm, në dyshimin për cënimin e pronësisë intelektuale. Struktura doganore vazhdojnë verifikimin e mëtejshëm të rastit. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është në angazhim të plotë, me të gjitha strukturat e saj, për të bllokuar çdo tentativë abuzimi apo shkelje të ligjit.



DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Administrata Doganore Shqiptare

dogana.shqiptare Dogana Shqiptare

Newsletter | Mars 2026

FIRMOSET PLANI OPERACIONAL DOGANA-TATIME PËR MONITORIMIN E TREGUT TË KARBURANTEVE

Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave u zhvillua takimi i parë i punës mes dy administratave doganore e tatimore, i drejtuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, Ilir Binaj. Dy drejtuesit firmosën Planin Operacional për monitorimin dhe kontrollin e mbajtjes, përdorimit dhe tregimit me pakicë të produkteve energjetike, dokumentin që përcakton organizimin e kontroleve të përbashkëta në terren dhe mekanizmat e koordinimit mes dy institucioneve. Në kuadër të këtij operacioni, grupe të përbashkëta kontrolli nga të dy administratat do të zhvillojnë verifikime në subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, duke kontrolluar dokumentacionin e furnizimit, origjinën e produktit, përputhshmërinë e sasive të tregtuara dhe fiskalizimin e shitjeve. Kontrollat do të shtrihen në të gjithë territorin e vendit deri në 30 qershor 2026, bazuar në analizën e riskut dhe informacionet e disponueshme nga të dy institucionet.



TAKIM ME PËRFAQËSUES TË BIZNESEVE NGA KOSOVA PËR PËRMIRËSIMIN E PROCEDURAVE TË TRANZITIT

Drejtori i Përgjithshëm, z. Besmir Beja, priti në një takim një grup përfaqësuesish të bizneseve nga Kosova, të cilët operojnë kryesisht në sektorin e tekstilit dhe këpucëve dhe që përdorin Portin e Durrësit për importin e mallrave nga vendet e treta drejt Kosovës. Takimi kishte në fokus diskutimin e procedurave të tranzitit të mallrave dhe identifikimin e mundësive për përmirësimin e mëtejshëm të tyre, duke ruajtur njëkohësisht standardet e kontrollit doganor. Drejtori i Përgjithshëm vlerësoi dialogun me komunitetin e biznesit si një element të rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve doganore dhe për forcimin e bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Kosovës. Përfaqësuesit e bizneseve nga Kosova shprehën vlerësimin për pritjen dhe gatishmërinë për dialog nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke theksuar besimin se bashkëpunimi do të vijojë të forcohet edhe më tej në të ardhmen.

DOGANA SHQIPTARE PJESË E USHTRIMIT NDËRINSTITUCIONAL PËR BIOSIGURI

Në Pikën e Kalimit Kufitar Tushemisht, u zhvillua një ushtrim stimuluar në terren në kuadër të projektit të Bashkimit Europian, i cili ka si qëllim forcimin e kapaciteteve të Shqipërisë në fushën e biosigurisë dhe biosigurimit. Ky aktivitet u organizua nga Dogana Shqiptare në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) dhe institucionet e shëndetit publik, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik (ISHP),

Institutin e Shëndetit të Shkollës dhe të Fëmijës (ISHSH), Organizatat e Shëndetit Kombëtar për Shëndetin e Popullatës (OSHKSH) dhe Urgjencën Mjekësore. Ky ushtrim është pjesë e strategjisë së Bashkimit Europian për forcimin e kapaciteteve në biosiguri, duke ofruar një platformë praktike për testimin e protokolleve të emergjencës dhe për zhvillimin e aftësive të stafit në situata reale.

DOGANA SHQIPTARE DHE AUTORITETI PORTUAL DURRËS BASHKËPUNIM PËR MODERNIZIMIN E PROCEDURAVE

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, u takua me Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit Portual Durrës, Liburn Aliu. Në fokus të diskutimeve ishte roli kyç i Administratës Doganore në garantimin e përpunimit sa më të shpejtë, të sigurt dhe transparent të mallrave, përmes përmirësimit të procedurave dhe rritjes së efikasitetit operacional. Diskutimet u përqendruan në avancimin e proceseve doganore, përmes përmirësimit të procedurave në hyrje dhe dalje të mallrave, si dhe në optimizimin e kohës së përpunimit të kontejnerëve. Një theks i veçantë iu kushtua forcimit të analizës së riskut, me qëllim orientimin më të saktë të kontroleve drejt ngarkesave me risk të lartë, duke mundësuar njëkohësisht lehtësimin e procedurave për operatorët ekonomikë të besueshëm. Palët riafirmuan angazhimin për të vijuar punën e përbashkët në drejtim të digjitalizimit të proceseve, rritjes së ndërveprimit ndërinstitucional dhe zbatimit të praktikave bashkëkohore, me qëllim rritjen e efikasitetit, sigurisë dhe konkurrueshmërisë së shërbimeve doganore në Portin e Durrësit, në përputhje me standardet europiane.



DREJTORI I DOGANAVE TAKIM ME PËRFAQËSUES TË BIZNESEVE QË OPEROJNË NË ZONËN E LIRË DOGANORE TË PORTO ROMANOS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një takim pune me përfaqësues të bizneseve që operojnë në Zonën e Lirë Doganore të Porto Romanos, një njeje strategjike për importin dhe menaxhimin e hidrokarbureve në vend. Në fokus të diskutimeve ishin zhvillimet më të fundit në tregun e hidrokarbureve, si dhe ndikimi i tyre në zinxhirin e furnizimit, nga importi deri në depozitimin dhe shpërndarjen në tregun vendas. Bizneset vlerësuan funksionimin normal të procedurave dhe bashkëpunimin me administratën doganore, duke theksuar rëndësinë e vazhdimësisë së këtij standardi. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vlerësoi bashkëpunimin me operatorët ekonomikë, duke theksuar se administrata doganore mbetet e angazhuar për të lehtësuar procedurat, duke ruajtur njëkohësisht standardet e kontrollit dhe sigurisë.



PREZANTOHET KRYETARI I RI I DEGËS DOGANORE FIER

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, prezantoi përpara stafit të Degës Doganore Fier, kryetarin e ri të kësaj dege, z. Eridjol Xhafa. Gjatë takimit me administratën, Drejtori i Përgjithshëm falënderoi z. Kosta Vjero për kontributin dhe punën e tij në drejtimin e Degës Doganore Fier, duke vlerësuar përkushtimin dhe përgjegjshmërinë e treguar gjatë ushtrimit të detyrës. Në prezantimin e drejtuesit të ri, z. Beja theksoi se Eridjol Xhafa merr detyrën në një moment që kërkon vijimësi në arritjet e deritanishme, por edhe një qasje të vendosur për përmirësimin e mëtejshëm të proceseve të punës, forcimin e kontrollit dhe rritjen e performancës administrative. Ai nënvizoi se Dega Doganore Fier ka një rol të rëndësishëm në mbledhjen e të ardhurave dhe në garantimin e zbatimit korrekt të legjislacionit doganor, duke kërkuar nga stafi profesionalizëm të lartë, integritet dhe bashkëpunim të ngushtë në funksion të objektivave të institucionit.

BLOKOHET 1 TON MJALTË PA DOKUMENTACION



Dega e Doganës Kapshticë ka bllokuar rreth 1 ton mjaltë, sasi që nuk kishte dokumentacionin përkatës për të vërtetuar sigurinë ushqimore të produktit. Sasia e ardhur për import dhe tregtim në vendin tonë është bllokuar në magazinën doganore deri në kryerjen e të gjitha analizave dhe procedurave të kërkuara ligjore. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave dhe strukturat e saj e vlerësojnë me prioritet sigurinë ushqimore. Mbrojtja e konsumatorit dhe garantimi i standardeve të sigurisë në import mbeten objektiva parësore edhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional.

BLOKOHEN 1,5 TONË ÇOKOLLATA

Drejtorja e Antikontrabandës ka bllokuar një mjet të ngarkuar me 1.5 tonë çokollata, i cili kaloi në degën doganore të Kapshticës pa kryer deklarim doganor dhe pa pasur asnjë dokumentacion mbi produktin, që mund të hidhej në treg të lirë. Pas kontrollit të plotë të mjetit, u konstatua se malli ndodhej në 566 kuti me çokollata, rreth 1.500 kg, që tentuan të futeshin në treg. Organet hetimore doganore po vazhdojnë punën për procedimin penal në organet kompetente.



TAKIM RAJONAL PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE KUNDËR PËRHAPJES SË ARMËVE TË SHKATËRRIMIT NË MASË

Në Shkup u zhvillua takimi për rritjen e kapaciteteve kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, i organizuar nga Qendra Rajonale për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë, RACVIAC në kuadër të iniciativave rajonale për forcimin e kapaciteteve në luftën kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë (WMD). Ky aktivitet, pjesë e iniciativës rajonale për kundërpërhapjen e WMD-ve, synon të mbështesë vendet anëtare të RACVIAC në identifikimin dhe zhvillimin e nevojave, si dhe në përmirësimin e aftësive institucionale për të parandaluar përhapjen e paligjshme të materialeve të ndjeshme, mallrave me përdorim të dyfishtë dhe prekursorëve të lidhur me to. Pjesëmarrja në këtë aktivitet paraqet një rëndësi të veçantë për Administratën Doganore Shqiptare, duke qenë se Dogana ka një rol kyç në kontrollin e mallrave në kufi, identifikimin e materialeve të rrezikshme dhe zbatimin e regjimeve ndërkombëtare të kontrollit të eksportit dhe masave shtrënguese ndërkombëtare.



DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Administrata Doganore Shqiptare

dogana.shqiptare Dogana Shqiptare

Newsletter | Mars 2026



DOGANAT BLOKOJNË MALLRA TË DYSHUARA PËR SHKELJE TË PRONËSISË INTELLEKTUALE

Drejtorja e Antikontrabandës dhe Drejtorja e Monitorimit, në bashkëpunim dhe koordinim intensiv me degët doganore në Kakavijë dhe në Durrës, kanë bllokuar 5340 palë atlete, që çënojnë pronësinë intelektuale për markat. Mallrat u përkasën markave "Christian Dior" dhe "New Balance" dhe bllokimi u krye në dyshimin për cënim të të drejtave të pronësisë intelektuale. Bllokimi i mallrave u realizua në kuadër të angazhimit të Drejtorisë Përgjithshme e Doganës për garantimin e barazisë në tregëtinë e lirë dhe zbatimin e ligjit. Strukturat doganore po vijojnë verifikimet e mëtejshme për rastet. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave mbetet e angazhuar maksimalisht për të parandaluar çdo tentativë abuzimi apo shkelje të ligjit.



RRITEN KONTROLLET DOGANORE NDAJ SUBJEKTEVE TË AKCIZËS

Administrata Doganore ka shtuar kontrollet për respektimin e detyrimeve ligjore nga subjektet që prodhojnë dhe tregtojnë mallra akcize, kryesisht pije alkoolike. Kontrollat janë përqendruar në verifikimin e lexueshmërisë së pullave fiskale të vendosura në produktet e gatshme në magazinat fiskale të subjekteve, në kontrollin e gjendjes së stokut të pullave fiskale të operatorëve, si dhe në inventarizimin e plotë të mallrave të akcizës (lëndë e parë, produkte të gatshme dhe produkte të ndërmjetme) në magazinat e tyre. Në përfundim të kontrolleve pranë një operatori, Dega Doganore Berat ka konstatuar shkelje të ndryshme, duke vendosur shpalljen debitor të subjektit në vlerën 45.7 milionë lekë. Nga kjo shumë, detyrimi përbën 8.7 milionë lekë, ndërsa penaltitetet arrijnë në 37 milionë lekë. Administrata Doganore mbetet e angazhuar për të vijuar kontrollet në funksion të respektimit të detyrimeve që burojnë nga ligji "Për akcizat", për të gjithë operatorët ekonomikë.



DOGANA DHE POLICIA E SHPETIT, KONTROLLE KUNDËR PALIGJSHMËRIVE

Dega e Doganës Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit të Policisë së Shtetit, ka zhvilluar një operacion të përbashkët kontrolli në kuadër të parandalimit dhe evidentimit të paligjshmërive në fushën doganore. Operacioni u realizua mbi bazën e analizës së riskut dhe informacioneve operative, duke përfshirë kontrolle të detajuara ndaj subjekteve dhe mjeteve të dyshuara. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave dhe Policia e Shtetit mbeten të angazhuara në vijimësi për forcimin e kontrolleve dhe garantimin e një mjedisit të sigurt dhe transparent për aktivitetet tregtare.

DOGANAT SHQIPTARE NË TAKIMIN RAJONAL MBI AMENDAMENTET PËR MBETJET ELEKTRONIKE

Përfaqësues të Administratës Doganore Shqiptare morën pjesë në takimin rajonal mbi amendamentet për mbetjet elektronike (E-waste) për vendet e Europës Lindore, organizuar në Bratislavë, Sllovakia, nga Sekretariati i Basel Convention në kuadër të Konventave BRS (Basel, Rotterdam dhe Stockholm). Ky takim rajonal, i zhvilluar në formën e një tryeze bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente, u fokusua në zbatimin e amendamenteve të reja të Konventës së Bazelit lidhur me lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve elektronike, forcimin e procedurës së Pëlqimit Paraprak të Informuar (PIC), si dhe në përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkufitar ndërmjet autoriteteve përgjegjëse. Administrata Doganore mbetet e angazhuar në forcimin e kontrollit të mallrave me risk mjedisor dhe në konsolidimin e rolit të saj si një aktor kyç në mbrojtjen e mjedisit, shëndetit publik dhe interesit kombëtar.



DOGANAT SHQIPTARE PJESË E TRAJNIMIT PËR SIGURINË E KUFIJVE

Në kuadër të angazhimit për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal, Doganat Shqiptare morën pjesë në trajnimin "Siguria e Kufijve dhe Ndalimi i Armëve të Dëmtimit në Masë (ADM)", organizuar nga RACVIAC - Qendra për Bashkëpunim për Siguri në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë. Trajnimi mbledhi përfaqësues të institucioneve nga vende të ndryshme të rajonit, duke shërbyer si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e eksperiencave, praktikave më të mira dhe koordinimin e veprimeve në fushën e sigurisë kufitare. Gjatë aktivitetit u trajtuan çështje që lidhen me identifikimin dhe parandalimin e kërcënimeve që lidhen me përhapjen e armëve të dëmtimit në masë, forcimin e analizës së riskut, si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.



DOGANA SHQIPTARE PJESË E SESIONIT TË KOMITETIT TË NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË OBD

Dogana Shqiptare mori pjesë në Bruksel në sesionin e radhës të Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve të Organizata Botërore e Doganave, një forum i rëndësishëm ku administratat doganore nga e gjithë bota shkëmbejnë përvoja dhe diskutojnë zhvillimet më të fundit në fushën e modernizimit dhe forcimit të kapaciteteve institucionale. Gjatë këtij sesioni, përfaqësues të administratave doganore dhe partnerëve ndërkombëtarë diskutuan mbi mënyrat për të rritur efektivitetin e programeve të ndërtimit të kapaciteteve dhe për të siguruar që reformat dhe iniciativat në këtë fushë të prodhojnë rezultate të qëndrueshme dhe të matshme. Pjesëmarrja e Doganës Shqiptare në këtë sesion përbën një mundësi të rëndësishme për të ndjekur nga afër praktikën më të mirë ndërkombëtare, për të forcuar bashkëpunimin me administratat tjera dhe për të mbështetur proceset e vazhdueshme të modernizimit të administratës doganore në vend.



VIJON BASHKËPUNIMI MES DOGANËS SHQIPTARE DHE ASAJ ITALIANE

Përfaqësues të Administratës Doganore Shqiptare morën pjesë në një vizitë studimore të organizuar nga Agjencia Italiane e Doganave dhe Monopoleve, në kuadër të instrumentit TAIEX të Komisioni Europian. Aktiviteti u zhvillua me fokus deklarimin e parasë (cash) dhe kontrollet në kufi, si pjesë e procesit të përrafimit të legjislacionit dhe procedurave të Administratës Doganore Shqiptare me standardet e Bashkimit Europian. Qëllimi i kësaj vizite ishte mbështetja e Administratës Doganore Shqiptare në përgatitjen dhe zbatimin e sistemit të deklarimit të parasë sipas legjislacionit të Bashkimit Europian. Programi përfshiu gjithashtu studime rastesh dhe operacione të përbashkëta doganore që lidhen me deklarimet e parasë, duke ofruar shembuj praktikë mbi identifikimin e riskut dhe procedurat e kontrollit. Përmes aktivitetëve të tilla, Administrata Doganore Shqiptare vijon të thellojë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet europiane, duke promovuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në fushën doganore.

